

# Demencë e vrigullit ballor

FLETË ME TË DHËNA NGA QENDRA SUEDEZE E DEMENCËS

Frontotemporal demens • faktablad på albanska

## Prek pjesët e përparme të trurit

Demenca e vrigullit ballor quhet edhe demenca e lobit ballor ose demenca e vrigullit ballor. Sëmundja të shpie që qelizat nervore thahen në pjesët e përparme të trurit, në lobin ballor ose në pjesën e përparme ose lobin temporal, prapa tëmthit. Simptoma vjen zakonisht tinëz, në të njëjtën mënyrë si në rastin e sëmundjes Alzheimer. Por ka edhe dallime vendimtare në mes të dy sëmundjeve të demencës.

## Asnjë simptomë të zakonshme të demencës

Harresa dhe vështirësitë të mësosh gjëra të reja, të cilat janë shenja të hershme të Alzheimerit, nuk janë tipike për demencën e vrigullit ballor. Nëse simptomat e tilla duken vonë në rrjedhën e sëmundjes. Demenca e vrigullit ballor karakterizohet, ose nga ndryshimet në sjellje, ose vështirësi të gjuhës, varësisht se në cilën pjesë të trurit fillon procesi i sëmundjes.

## Personaliteti ndryshon

Shpesh është lobi ballor ai që lëndohet fillimisht, në rast të demencës së vrigullit ballor. Nga këtu drejtohet koncentrimi, gjykimi dhe kontrolli i impulsit. Personaliteti tek ai i cili është sëmurë, fillon të ndryshoj ngadalë dhe personi sillet në shumicën e rasteve me mungesë gjykimi.

Vështirësitë e shtuara për të marrë iniciativë dhe shpërthim zemërimi të pashpjegueshëm, janë shenja të tjera të hershme. Është e zakonshme, se personi mund të jetë i parehatshëm, i topitur nga aspekti i ndjenjave dhe ndonjëherë ndjen apati. Aftësia të ndjej për të tjerët vjen e zvogëlohet. Edhe konsumimi i tepërt i ushqimit, pirja e duhanit ose pirja e alkoolit, mund të ndodhin.

## Vështirësi në gjuhë, në disa raste.

Demenca e vrigullit ballor mundet, po ashtu, të filloj në pjesën e përparme të lobeve temporale, të cilat janë të rëndësishme për gjuhën. Në këto raste, flitet për *afazi progresive*. Kjo mund të shprehet si zvogëlim i të kuptuarit të fjalëve, si dhe problem të emërtoj gjërat e ndryshme, si veturë ose çelës. Mund të shprehet si një e folme e ngathët dhe e „copëtuar“, me shumë gabime gramatikore.

## Ka nevojë, edhe për më shumë ndihmë

Nuk është e rrallë, që demenca e vrigullit ballor debuton, që nga moshë e sipërme e moshës mesatare. Sëmundja mundet, më pas, të vazhdojë, për shumë vite. Simptomat bëhen më të shumta dhe gradualisht edhe më të forta, në takt me përhapjen e dëmtimit të trurit. Bëhet gjithnjë më e vështirë, për t'ia dalë jetës së përditshme, dhe pak nga pak, personi ka nevojë për ndihmë me veshjen e rrobave, higijenën dhe përkujdesjen tjetër personale.



## Diagnoza e hershme është e rëndësishme

Demenca e vrigullit ballor, mund të ngatërrohet me depresionin, sindromën e raskapitjes, ose të ndonjë shëndeti tjetër të lig. Pasi që harresa dhe simptomat e tjera tipike të demencës, në fillim, janë të rralla, sëmundja mund të jetë e vështirë të zbulohet.

Kontaktto një mjek, nëse ti dyshon, që ti ose një i afërm, mund të jetë i prekur, nga demenca e vrigullit ballor. Një shqyrtim i gjendjes, duhet menjëherë të filloj. Kjo bëhet zakonisht në një klinikë specialistësh (njësi pranuese të memories) dhe përmban disa lloje të testeve dhe kontrollimeve, si dhe intervista me të afërmit.

## Trajtimi dhe sjellja

Hulumtimi ka arritur sukses, por akoma nuk ka ndonjë mënyrë të ndalohet rrjedha e sëmundjes, në rastin e sëmundjes së demencës së vrigullit ballor. Megjithatë, është me rëndësi të marrësh një sqarim për simptomën, për të mundur planifikuar një jetë sa më të mirë e kuptimplotë të mundshme.

Mjetet ndihmëse dhe përkujdesja e mirë, në mënyra të ndryshme, mund të lehtësojnë jetën. Është, po ashtu, me rëndësi të mundohesh të krijosh qetësi dhe rehati, rreth e përçark të sëmurit, pasi që stresi shpesh e forcon simptomën.

17 dhjetor 2018 • Qendra suedeze e demencës ©

Më shumë fletë me të dhëna në gjuhë të ndryshme, mund të printohen nga uebfaqja e Qendrës suedeze të demencës: [www.demenscentrum.se/Faktablad](http://www.demenscentrum.se/Faktablad)



Svenskt Demenscentrum

Svensk Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, 08 - 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)